

# 2006

## Dogana

- \* Të Hyrat
- \* Lehtësirat Tregtare
- \* Mbrojtja e Shoqërisë



Shërbimi Doganor i UNMIK-ut  
Bulevardi Bill Clinton p.n.  
Prishtinë, Kosovë,  
Tel. 038 540 350  
Fax. 038 540 836  
email: [hq@unmikcustoms.org](mailto:hq@unmikcustoms.org)  
[www.unmikcustoms.org](http://www.unmikcustoms.org)



UNMIK CUSTOMS SERVICE  
HIERARCHY CHART  
ORGANOGRAMI I HIERARKISË NË  
SHËRBIMIN DOGANOR TË UNMIK-UT  
HIJERARHIJSKI ORGANOGRAM  
CARINSKE SLUZBE UNMIKA

Approved from  
Director General  
Aprovuar nga  
Drejtori Gjeneral  
Usvoljo  
generali/direktor

DEPUTY DIRECTOR GENERAL  
ZËVENDËS DREJTORI GJENERAL  
ZAMENIK GENERALNOG DIREKTORA



DIRECTOR GENERAL  
DREJTORI GJENERAL  
GENERALNI DIREKTOR



ASSISTENT DIRECTOR /HEAD OF UNIT  
ASISTENT DREJTOR /KREU I SEKTOR  
POMOČNIK DIREKTORA/NACJELNIK SEKTORA



DIRECTOR  
DREJTOR  
DIREKTOR



DEPUTY DIRECTOR  
ZËVENDËS DREJTOR  
ZAMENIK DIREKTORA



CUSTOMS OFFICER  
ZYRTAR DOGANOR  
CARINIK



HIGH CUSTOMS OFFICER  
ZYRTAR I LART DOGANOR  
VIŠI CARINIK



SHIFT LEADER  
UDHËHEQËS NJËSITI-NDËRRIMI  
ŠEF SMENE



## Qëllimet

1. **Të** administrojë në mënyrë korrekte dhe efikase sistemin e themeluar me ligjin e doganave dhe kontrollin e taksave për mallrat e importuara dhe eksportuara nga Kosova dhe çdo çështje tjetër e cila mund të caktohet herë pas here.
2. **Të** mbrojë të hyrat dhe komunitetin nga efektet e dëmshme apo mashtrimet dhe kontrabandimi i mallrave komerciale, drogave ilegale dhe mallrat e tjera të ndaluara.
3. **Të** zhvillojë Shërbimin për të arritur plotësimin e sfidave të komunitetit të bizneseve dhe progresin krahasues kundrejt kërkesave të UE (dokumenti i Blueprint- it për Doganat) dhe Standardeve për Kosovën.
4. **Të** punojë bashkë dhe në sinergji me agjencitë dhe departamentet tjera të angazhuara në kufij dhe në zbatimin e taksave, si dhe me CAFAO-UNMIK dhe programet tjera të asistencës teknike.

## Objektivat

Objektiva 1: Mbledhja e të hyrave të duhura në kohë të duhur nga TVSH-ja në import, akciza dhe obligimet doganore.

Objektiva 2: Lehtësirat tregtare Promovimi i komunikimit dhe bashkëpunimit nacional me komunitetin e biznesit të Kosovës, shërbimet qeveritare dhe ndërkombëtare me administratat e tjera Doganore në regjion, si dhe lehtësirat tregtare në bashkëpunim me biznesin.

Objektiva 3: Shfrytëzimi i fuqive dhe procedurave të Kodit Doganor dhe Kodit të Akcizave për efekt më të mirë, për të përmirësuar përmbushjen.

Objektiva 4: Zhvillimi i mëtejme i kapaciteteve të zbatimit të ligjit për:

- a. parandalimin dhe zbulimin e mashtrimeve, kontrabandimit të mallrave komerciale, drogave ilegale dhe mallrat tjera të ndaluara dhe të kufizuara, dhe
- b. të hetojë dhe përndjek kundërvajtjet nën udhëheqjen e Prokurorit publik.

Objektiva 5: Zhvillimi i kapaciteteve të tjera përbrenda shërbimit për të avancuar integritetin, zhvillimin e resurseve, politikave, kornizën ligjore, të arrijë më shumë transparencë dhe përdorë praktikë sa më të mirë.

## Hyrje

Një vit i shquar për Shërbimin Doganor të UNMIK-ut në arritjen në kushte reale të rritjes prej 12,5 % në krahasim me vitin e fundit dhe atë kryesisht, për shkak të rritjes së efikasitetit në arkëtimin, trajtimin e problemeve të përmbushjes, procedurave të thjeshtësuara në përfitim të tregtisë dhe të ekonomisë, si dhe parandalimi dhe luftimi efikas i praktikave korruptive.

Ka nevojë për një investim më të madh në shërbim për të konsoliduar dhe përmirësuar aktivitetin qoftë edhe në përfitim të mëtejshëm për arkëtimin e të hyrave dhe mbrojtjen e shoqërisë nëpërmes të luftimit të kontrabandimit; në staf duke përmirësuar pagesën sipas aktivitetit të kryer dhe pagesave në bonus për të cilin propozimet e Doganës nuk e dëmtojnë procesin e shpenzimit të buxhetit dhe pajisjet më moderne të detektimit të cilat i mungojnë shërbimit.

Peter Walker  
Drejtor i Përgjithshëm

## Shërbimi Doganor i UNMIK-ut Plani i Menaxhimit 2006

OBJEKTIVAT	INDEKSI
1. Të hyrat	Pjesa I
2. Lehtësirat tregtare	Pjesa II
3. Përmbushja	Pjesa III
4. Zbatimi i ligjit	Pjesa IV
5. Ndërtimi i kapaciteteve	Pjesa V

## OBJEKTIVI 1

Mbledhja e taksave doganore përkatëse në kohë të duhur nga TVSH në import, akcizë dhe taksa doganore

# 459,606,880.27


Mbledhja e Taksave €34.3m (+ 8%) mbi planifikim.

Mbledhja e përgjithshme ka qenë €459.6milion ndaj buxhetit të parashikuar nga MFE, që ishte €425.3 milion. E kjo përbën 108% nga e pritura.

Kjo rritje në vitet e fundit regjistron mbledhjen prej €436 milion që në të vërtet është në rrethinën e 12.5 %, duke marrë parasysh ndryshimet strukturale në metodat e arkëtimit, rabateve dhe ndryshimeve në shkallët e tatimeve së bashku me efektet e marrëveshjes për tregti të lirë.


Një pjesë e rëndësishme është nga përmbushja më e mirë në arkëtim, që është si rezultat i futjes së teknikave të bazuara në rrezik; auditimeve pas importimit, kontrollës më të mirë në gjysmën e dytë të vitit të fundit; problemet e përmbushjes në Veri për tregti me apo nëpërmjet Serbisë.

Shuma totale €4.7milion erdhi nga vlerësimi dhe mbledhja e tatimeve doganore, si dhe tatimit të papaguar që është identifikuar pas kryerjes së zhdoganimit nëpërmes të ekipeve të auditimit të jashtëm duke punuar së bashku me ATK-në.




Ky diagram tregon rritjen e të ardhurave në kufij dhe të akcizës së brendshme të mbledhura nga Doganat. Pasi zhvillimi ekonomik është ngadalësuar niveli i të hyrave është mbajtur, duke rritur përmbushjen e tatimeve dhe ndryshimet në tarifatat e vëna.

## Të hyrat të analizuara sipas llojit në Miliona




Kjo analizon të hyrat duke ndarë në miliona sipas llojit të tatimit. TVSH është kontribuuesi më i madh në BKK.

- Vërejtje: Kategoria "të hyrat e tjera" përmban të hyrat e arkëtuara nga ankandet publike nga shitja e mallrave të kontrabanduara, kontrollet e jashtme, revizioni.




## Ndarja e të hyrave të 2006 sipas tatimeve



Përqindja prej 459.6 milionësh e ndarë sipas llojit.

\*Shënimet janë treguar në % për të hyrat e tjera nga totali i mbledhur 2006.


## Pjesëmarrja e Doganave në BKK



Ky diagram tregon kontributin e arkëtimit doganor për Fondin e Konsoliduar të Kosovës. Shërbimi Doganor është ende arkëtuesi më i madhi për BKK (Buxheti i Konsoliduar i Kosovës). Nga totali i të hyrave të planifikuara ky diagram i referohet pjesës së të hyrave nga tatimet.

Të dhënat janë në miliona.


## Të hyrat totale buxhetore të Kosovës 2006



Nga totali i të hyrave në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, Shërbimi Doganor i UNMIK-ut merr pjesë mbi 70%.

\*të hyrat nga SHDU janë me ngjyrë të kaltër.


## Të hyrat Profili dhe mbledhja 2006



Diagrami tregon krahasimin ndërmjet të hyrave të 2006 dhe të hyrave të planifikuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Doganat kanë tejkaluar planin për më shumë se € 34.3 milion. Megjithatë duhet thënë se për shkak të problemeve të shkaktuara nga pagesat e zhdoganimit bankar disa nga sasi të pranuar për në BKK, do të kryhen në ditët e para bankare të 2007-tës.

## Të hyrat neto 2005-2006

Më poshtë mund të shihet krahasimi i të hyrave dhe rikthimet ndërmjet viteve 2005 dhe 2006. Niveli i rikthimeve është më i ulët si rezultat i ndryshimeve në mënyrën se si lirimet janë rikthyer.



Në vitin 2006 ne kemi mbledhur më shumë të ardhura neto se sa në vitin 2005 për më shumë se 31.1 milion euro.

\*Të ardhurat neto janë të hyrat bruto minus rikthimet

## Të hyrat

Projekti IBM me pjesëmarrje të plotë të doganave.

Me qëllim të thjeshtësimit të procedurave dhe me aspiratën e krijimit të “dritares së vetme” në të ardhmen, Doganat kanë marrë pjesë aktive në projektin e Agjencionit Evropian për Rindertim, respektivisht Menaxhimin e Integruar të Kufijve (IBM). Janë nënshkruar Protokollat e punës me policinë kufitare dhe është zhvilluar plani i përbashkët i veprimit, si dhe është miratuar nga të dy taboret menaxhuese. Edhe pse ka ende probleme praktike në pikë kalime kufitare problemet që janë identifikuar janë duke u zgjidhur veçmas sipas rastit..

Është nënshkruar MOU (Memorandumi i Mirëkuptimit me Agjencinë Bujqësor të Kontrollit Kufitar dhe bashkëpunimi është përmirësuar gjatë vitit. Doganat kanë marrë pjesë në të gjitha takimet e grupit drejtues EAR IBM dhe kanë dhënë kontributin në formulimin e strategjisë nacionale IBM, e cila tani është paraqitur në Qeveri (nën udhëheqjen e Ministrisë së Brendshme).



## Lehtësirat në Tregti

### OBJEKTIVI 2

Promovimi i komunikimit dhe bashkëpunimit vendor me komunitetin e biznesit Kosovar, shërbimin qeveritar dhe ndërkombëtarisht me administratat e tjera doganore në regjion.

Lehtësirat në tregti kanë mundësuar që nga 90 % e deklarimeve të paraqiten në formen elektronike nëpërmjet DTI (të dhënave direkt të tregtarëve). Gjatë vitit Doganat kanë punuar në mënyrë të afërt me organizatat e biznesit dhe në veçanti me Oden Ekonomike të Kosovës, Aleancën Kosovare të Biznesit, Oden Ekonomike Amerikane, duke marrë pjesë në të gjitha seminarët dhe punëtoritë e organizuara.


Janë bërë diku 39 autorizime për Depo doganore së bashku me 21 autorizime për përpunim të brendshëm dhe 9 autorizime për përpunim të jashtëm.

Një tregues i shtimit aktual të aktivitetit ekonomik në sektorët përkatës.

Raportet me agjentët doganor vazhdojnë të përmirësohen dhe shtrirja e TIMS-it (Sistemi kompjuterik i të dhënave të import-eksportit) është arritur të përfundohet në të gjitha pikë-kalimet, duke çuar në 90 % të deklarimeve, që janë paraqitur në formën elektronike nga të Dhënat Direkte të Tregtarëve.




## Lehtësirat në tregti



Më lartë janë dhënë numrat e autorizimeve doganore të lëshuara për procedura të ndryshme. Këto procedura tregojnë se tregtia ka rritur shfrytëzimin e tyre, për shkak se ato janë të afërta për tregtinë.

## Lehtësirat në tregti



Të dhënat e përgjithshme në raport me qarkullimin e brendshëm të mallrave në depo doganore dhe shkarkimi nga to.

Të dhënat janë në milion

## Përmbushja

### OBJEKTIVI 3

Shfrytëzimi i kompetencave dhe procedurave në Kodin Doganor për të arritur përmbushje sa më të mirë dhe lehtësimin e aktivitetit ekonomik në bashkëpunimin me biznesin.

Dogonat gjatë vitit 2006 kanë punuar më tutje në drejtim të vetëdijesimit të tatimpaguesve kosovar, duke iu sqaruar atyre obligimet që kanë në lidhje me pagimin e tatimeve, por në ndërkohë edhe për mundësitë që ata kanë në përfitim, nëse ata shfrytëzojnë procedurat me ndikim ekonomik që ofron Legjislacioni Doganor.


Dogonat kanë luajtur rol aktiv në takimet me bizneset, prandaj ne besojmë fuqishëm se kjo do të ndikoj më shumë biznese që të kuptojnë obligimet e tyre, por gjithashtu edhe të bëhen të rregullt dhe vullnetar në pagimin e tatimeve që ju takojnë atyre.

Duke filluar nga 15 janari 2006, Dogonat kanë miratuar një strukturë të re organizative e ngjashme me organizatat e tjera moderne doganore dhe Konventës së rishikuar të Kiotos. Si rezultat i një organizimi të tillë janë themeluar njësitë e kontrollit të jashtëm apo njësitë e kontrollit pas importit, të cilat njësi bazohen në analizimin e profilizuar të rrezikut, që është bërë nga njësitë e tjera në kuadër të Shërbimit Doganor që janë fokusuar në kontrollimin e kompanive që janë vlerësuar me rrezik të evazionit nga pagesa e tatimeve.


Me qëllim të shpejtimin të procedurave në kufi, fokusimi në kargo që janë vlerësuar me rrezik ka rezultuar në zvogëlim të numrit të automjeteve të kontrolluara nga totali i automjeteve që kanë kaluar kufirin. Në Hanin e Elezit niveli i kontrollimeve në kargove komerciale është zvogëluar në 25 % nga totali i kargove. Kjo ka sjellë në rritjen e të ardhurave nga tatimet kufitare. Krahasuar me vitin e fundit kjo është kryesisht si rezultat i aplikimit të këtyre metodave që kanë rezultuar në arkëtimin e 18 milion euro (8%) më shumë se sa vitin e fundit nga ky pikëkalim që tregon për rezultatet e arritura.

## Përmbushja

### Kontrollet pas importit




Gjatë vitit të kaluar ne kemi ushtruar 136 auditime, 103 kanë rezultuar në kontrolle pas importit. Ne gjithashtu kemi patur bashkëpunim me ATK në 15 raste. 18 raste kërkojnë më shumë informacion dhe hetime




Të hyrat shtesë për t'u arkëtuar nga Dogonat si rezultat i kontrolleve të deponive doganore është ofruar në shtyllën e diagramit të treguar më lartë. Krahasuar me vitin paraprak ne kemi dyfishuar arkëtimin dhe zvogëluar borxhet.

## Përmbushja



Procedurat me ndikim ekonomik janë tregues që tregon se tregtia kosovare është duke u shërbyer me procedurat më të mirat. Më poshtë është dhënë krahasimi ndërmjet vitit të fundit dhe këtij viti. Gjithashtu, totali i autorizimeve valide të procedurave me ndikim ekonomik.



## Zbatimi i ligjit

### OBJEKTIVI 4

Zhvillimi i mëtejme i aftësive për zbatimin e ligjit:

a. parandalimi dhe detektimi i mashtrimit e të hyrave kontrabandimit të mallrave komerciale, drogave joligjore dhe mallrave të tjera të ndaluara dhe të kufizuara, dhe

b. hetimi dhe ndjekja e kundërvajtësve nën drejtimin e prokurorit publik.

Zbatimi i ligjit- €2.5m kontribut për të hyrat e përgjithshme nga pranuesit e tjerë. Mbi 600 procedura për shkelje administrative janë iniciuar gjatë vitit 2006 nga të cilat 43 janë proceduar për veprim nga ana e prokurorit.


Shuma prej €2.5m ka qenë kontribut për arkëtimin e të hyrave totale nga pranuesit e tjerë, kryesisht nëpërmjet të dënimeve, shitjes së mallrave të kapura dhe dënimeve nga detektimi e shkelësve dhe i veprimeve ndaj shkelësve.

Synimi ka qenë €2m dhe reflekton kualitetin e aktiviteteve kryesore. Diku €1m është akoma në pritje dhe duhet të realizohet në vitin 2007 kur të jenë përfunduar rastet.


## Zbatimi i ligjit



Gjatë vitit Njësit Antikotrabandë të Shërbimit Doganor kanë ushtruar 638 dënime administrative. Krahasuar me vitin paraprak kjo paraqet 20 % zvogëlim të kundërvajtjeve që është një tregues pozitiv i rregullimit të importit.



## Zbatimi i ligjit



### “Zero tolerancë ” Ndaj cigareve pa banderola

Aksionet kanë rezultuar në kapjen e sasisë prej 25.5 tonësh. Diagrami paraqet ndryshimin ndërmjet kapjeve gjatë dy vitesh.

Shtimi i sasisë së kapur gjatë vitit 2006 tregon se Doganat janë duke e rritur kualitetin e kundërvajtjeve, sepse numri i kundërvajtjeve ka rënë në përgjithësi.

## Zbatimi i Ligjit

### Njësia e hetimeve

Gjatë vitit 2006 Njësia e hetimeve ka regjistruar 160 raste të referuara nga njësiti apo degët, agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit apo të iniciuara nga njësia e hetuesisë.

Gjatë vitit pas ushtrimit të hetimeve në konsultim gjithnjë me zyrën e prokurorit ka përgatitur 40 kallëzime penale, ku shuma potenciale është 1.020.000 €.

Mbi 80% e kallëzimeve penale që janë proceduar tek prokurori janë pasuar me shqiptime dënimesh dhe që tregojnë për kualitetin e raporteve penale.

Nga kallëzimet penale 7 prej tyre janë kundër zyrtarëve doganor për shkak të dyshimit të keqpërdorimit të detyrës zyrtare.

Pas kryerjes procedurave të hetimeve brenda që gjithmonë bazohen në parimet e proporcionalitetit këtë vit ne kemi paraqitur 13 kërkesa për asistencë administrative jashtë Kosovës.

Rastet që mbeten hapur janë transferuar nga 2006 në vitin 2007 janë 54.

Këtë vit me urdhër të gjykatës janë ushtruar 4 bastisje në kompani të ndryshme përderisa 6 raste të tjera ne kemi shfrytëzuar autorizimet nga njësia e auditimit. Këto kontrolle kanë rezultuar me sukses të plotë në gjetjen e evidencës materiale dhe mallrave.

## Zbatimi i Ligjit

Kundërvajtjet kryesore 2006 .- Përgjithësimi i ngjarjeve më të rëndësishme gjatë tërë vitit që ilustron shkurtimisht aktivitetet e Shërbimit Doganor.



Më 1 korrik 2006, në autobusin që udhëtonte në linjen Kosovë-Turqi zyrtarët doganor kanë arritur të zbulojnë dhe kapin sasinë e substancave narkotike me sasi mbi 4 kg.



Në fillim të tetorit Doganat kanë shkatërruar një sasi të madhe të cigareve pa-banderola. Kjo sasi është kapur në raste të ndryshme nga njësiti e doganave, respektivisht nga njësiti e ndryshme anti-kontrabandë dhe degët e ndryshme doganore. Sasia e cigareve të shkatërruara ka qenë përafërsisht 21 ton, përderisa vlera totale e cigareve është vlerësuar 600.000 deri në 700.000 euro.



## Zbatimi i ligjit



Në muajin maj në pikën e kalimit kufitar të Vermices, njësitë kundër kontrabandës kanë arritur të zbulojnë një sasi të konsiderueshme të mjeteve materiale (para të gatshme, dollar) që janë transportuar për Kosovë. Këto mjete monetare kanë patur vlerën prej 70.000 US dollar, që janë gjetur në xhepin e personit.



Gjatë prillit e vlen të përmendet shkelja e zbuluar në Degën doganor të Aeroportit, gjatë një kontrolli rutinor ku janë gjetur një sasi e konsiderueshme e mjeteve stimuluese VIAGRA që janë gjetur në bagazhin e udhëtarit të pa-deklaruar.

## Zbatimi i ligjit



SHDU dhe ATK kanë aplikuar veprim të përbashkët të kontrollit të artarive që ka rezultuar në kapjen e mbi 130 kg ari. Në qytetin e Pejës janë kapur 90 kg, ari, derisa në Prizren janë kapur diku 33.5 kg. Kjo sasi konsiderueshme e arit të kapur vlerësohet në 1.3 milion euro. Përderisa tatimet e mbledhura vlerësohen në 300.000 euro.



Gjatë dhjetorit 2006, zyrtarët doganor në degë e Pejës kanë arritur të parandalojnë tentimin e kontrabandimit të cigareve në pikë-kalimin kufitar Kulla. Sasia e cigareve të zbuluara ka qenë mbi 1 ton.

## Ndërtimi i kapaciteteve

### OBJEKTIVI 5

Ndërtimi dhe zhvillimi i kapaciteteve në kuadër të shërbimit për të forcuar integritetin, zhvillimin e burimeve njerëzore, politikave, kornizës ligjore, arritjen e transparencës më të madhe dhe arritjes së përvojave më të mira


Burimet Njerëzore dhe Administrata e Doganave nga alokimi i tyre kanë shpenzuar brenda kufirit buxhetor. Doganat e UNMIK-ut kanë plotësuar gjithë objektivat e veta brenda buxhetit të alokuar 2006, me anë të aktiviteteve të prioritare..

Shpenzimi total ka qenë €8.3 milion ndaj asaj që ka qenë e alokuar prej €8.7m. Buxheti i paspenzuar ka qenë kryesisht në lidhje me shpenzimet kapitale që nuk janë prokuruar brenda afatit kohor për shkak të procedurave të prokurimit. Projekti kryesor kapital ka qenë instalimi i CCTV në të gjitha degët, që është kryer me kohë në dhjetor dhe do të bëhet plotësisht operacional në 2007-të.

Kufizimi në staf gjatë 2007 është 567 ndaj 577 sa janë planifikuar në fillim. Diku 82.7% të shërbimit janë shqiptarë të Kosovës dhe 17 % janë minoritar. Drejtori Ndërkombëtar i Zbatimit të Ligjit ka dorëzuar kompetencat në fund të vitit tek vendorët Kosovar dhe vetëm pozita e Drejtorit të Përgjithshëm është pozitë ndërkombëtare (përveç planit për veriun) dhe edhe kjo pozitë do të kosovarizohet nga 1 prilli 2007 si pjesë e tranzicionit. Kodi i Mirësjelljes i përmirësuar (standard i Organizatës Botërore të Doganave) është futur me sukses gjatë vitit. Njësia e Standardeve Profesionale (NjSP) ka filluar 51 raste për sjellje të keqe nga të cilat 45 janë kryer gjatë vitit. Dy zyrtarë janë larguar nga puna dhe 6 mbesin të suspenduar

## Standardet Profesionale

Njësia e Standardeve Profesionale ka ndërmarrë 45 hetime të brendshme gjatë vitit 2006. Kjo përfaqëson 9% të tërë stafit doganor. Një numër prej tyre janë hetuar së bashku me njësinë e doganës për hetimin e kriminalitetit. Gjithashtu, janë bërë një numër hetimesh për kundërvajtjet potenciale disiplinore që kanë rezultuar në ndjekjen nga gjyqi të zyrtarëve për ngarkim kriminal. Qëllimi i këtyre hetimeve ka qenë për të përcaktuar, nëse zyrtarët janë përpunur me procedurat dhe nëse atyre duhet t'u vazhdohet kontrata e punës në Dogana. Rezultatet janë treguar në diagramin e mëposhtëm:




Nga tabela e mësipërme mund të shihet:

- Totali i stafit që ka kaluar nëpër procedura disiplinore
- Degradimet
- Transferim disiplinor
- largimi nga puna
- Totali i të suspenduarve për 2006
- Paralajmërimet
- Lirimi nga përgjegjësia

## Ndërtimi i kapaciteteve

### Diversiteti




Në vitin 2006 numri total i punëtorëve të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut ka qenë 567.

Diagrami tregon përfaqësimin etnik në SHDU e shprehur në numra. SHDU ka plotësuar standardet e përfaqësimit etnik.

## Ndërtimi i kapaciteteve

### Struktura gjinore



Numri i konsiderueshëm i zyrtarëve femra punon në SHDU. Por, SHDU është e vetëdijshme se ky numër është i pamjaftueshëm dhe prandaj në çdo vend të lire pune femrat inkurajohen për të konkurruar.



# Organogrami

